

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE - SHKURT, MARS 2026

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	26.1.2026	Kërkohej relacioni i vendimit nr.845, datë 30.12.2025 Për krijimin e shoqërisë aksionare "Operatori i shërbimeve të integruara të procesit të sterilizimit".	9.2.2026	Kthim përgjigjeje, se në përputhje me nenin 17 të ligjit nr. 9000 datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", si dhe në kufizimet e përcaktuara nga neni 17 i ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ky informacion nuk mund t'i vihet në dispozicion.	Përfunduar	Nuk ka
2	9.3.2026	Në çfarë date është publikuar në faqen e kryeministritë https://www.kryeministria.al/plane-pune-dhe-strategjite/ vendimi nr. 16, datë 11.1.2024 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026"? Në çfarë date është publikuar në faqen e kryeministritë https://www.kryeministria.al/plane-pune-dhe-strategjite/ vendimi nr.812, datë 30.12.2025 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projekt akteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2026"? Në çfarë date është miratuar raporti "Raport mbi negociatat dhe integrimin evropian (periudha raportuese prill – qershor 2024)"? Në çfarë date është publikuar raporti "Raport mbi negociatat dhe integrimin evropian (periudha raportuese prill – qershor 2024)" në faqen e kryeministritë në chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/ https://www.kryeministria.al/wp-content/uploads/2024/11/Raport-3MII-2024.pdf	11.3.2026	Në datën 19.2.2024, është publikuar në faqen e kryeministritë https://www.kryeministria.al/plane-pune-dhe-strategjite/ vendimi nr. 16, datë 11.1.2024 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026". Në datën 6.1.2026, është publikuar në faqen e kryeministritë https://www.kryeministria.al/plane-pune-dhe-strategjite/ vendimi nr.812, datë 30.12.2025 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projekt akteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2026". Në datën 7.11.2024, është publikuar raporti "Raport mbi negociatat dhe integrimin evropian (periudha raportuese prill – qershor 2024)" në faqen e kryeministritë në chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcglclefindmkaj/ https://www.kryeministria.al/wp-content/uploads/2024/11/Raport-3MII-2024.pdf Raporti 3 mujor mbi negociatat hartohet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 15/2015 "Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", i ndryshuar, ku në nenin 14, pika 3, gërma "gj", përcaktohet se Komisioni për Çështjet Europiane kërkon raportime periodike çdo 3 muaj, nga ministri përgjegjës për negociatat në Bashkimin Evropian, lidhur ecurinë e procesit të negociatave. Përsa më sipër, nuk ka një akt formal që miraton raportet 3 mujore, por ato përgatiten dhe i përcillen Kuvendit pas përmbylljes së çdo 3 mujori.	Përfunduar	Nuk ka
3	9.3.2026	Kërkohej urdhri nr.13, datë 13.11.2023, i Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët për hartimin e projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 75/2019 "Për Rininë", si dhe dokumentacioni i përgatitur nga grupi i punës, në zbatim të këtij urdhri.	17.3.2026	Dërgohej urdhri nr.13, datë 13.11.2023, "Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e ligjit nr. 75/2019 "Për Rininë", i Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Të gjitha informacionet/raportet/relacionet e përgatitura nga grupi i punës, i ngritur për këtë qëllim, gjenden në linkun: https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/801	Përfunduar	Nuk ka
4	9.3.2026	Kërkohej informacion nëse është kryer vlerësimi i impaktit ex-ante (i pjesshëm apo i plotë) për aktet e renditura në tabelën e bashkëngjitur – aneksi 1 dhe nëse nuk është kryer, cila ka qenë arsyeja e moskryerjes së vlerësimit të impaktit ex-ante. Kërkohej pajisja me një kopje elektronike të dokumenteve të vlerësimit të impaktit ex-ante (vlerësim i pjesshëm ose i plotë) për secilin akt të listuar në tabelën e bashkëngjitur. Kërkohej pajisja me një kopje elektronike të relacionit shoqëruar të projekt-propozimit të secilit akt të renditur në tabelën e bashkëngjitur.	17.3.2026	Procesi i përgatitjes së raporteve të vlerësimit të ndikimit (RIA) për projektaktet e legjislacionit dytësor (projekvendime të një rëndësie të lartë) që miratohen nga Këshilli i Ministrave, do të fillojë zyrtarisht zbatimin, gjatë vitit 2027. Ky afat është dakordësuar me Komisionin Evropian dhe me OECD/SIGMA, si dhe është në përputhje me objektivat, angazhimet dhe afatet e përcaktuara në Strategjinë Ndërsëktoriale për Reformën në Administratën Publike 2025–2030. Sa i përket ligjit "Për një shtesë në ligjin nr. 7764, datë 2.11.1993, "Për investimet e huaja", i ndryshuar", ky akt është miratuar me propozim të një deputeti të Kuvendit të Shqipërisë. Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA, në Kryeministri, në zbatim të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" si dhe të Rregullores së Këshillit të Ministrave, është përgjegjëse për koordinimin e procesit të vlerësimit të ndikimit (RIA) në institucionet e qeverisjes qendrore, si dhe për mbikëqyrjen e cilësisë së raporteve RIA që përgatiten prej tyre, për projektakte të miratuara në Këshillin e Ministrave. Për projekt vendimet e listuara në Aneks, të cilat janë publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, gjenden dhe relacionet e publikuara: (https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Institucioni/114)	Përfunduar	Nuk ka
5	19.3.2026	Kërkesë për procedurat që ndiqen për ndryshimin e mbiemrit.	19.3.2026	Deleguar MPB, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.	Deleguar	Nuka ka
6	23.3.2026	Kërkohej informacion lidhur me hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit për Policinë së Shtetit (PSH), ligjit për Agjencinë e Mbrojtjes Policore (AMP) dhe ligjit për Policinë e Burgjeve (PB).	24.3.2026	Deleguar MPB dhe MD, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.	Deleguar	Nuka ka
7	31.3.2026	Kërkohej koment prej Qeverisë Shqiptare lidhur me sulmet e kryera nga "Homeland Justice" të cilat kanë prekur institucione kyçe dhe kanë ngritur dyshime mbi ekspozimin e të dhënave.	1.4.2026	Kthim përgjigjeje se bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e informimit", kërkesa për informacion duhet t' i referohet një dokumenti nëpërmjet të cilit kërkohej informacion. psh. strategji, ligj, VKM, Urdhër, Udhëzim etj, sepse ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit" rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, informacione, statistika, për t'ju përgjigjur pyetjeve, për të bërë komente etj.	Përfunduar	Nuk ka